



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 25 Prill 2023

Nr: 410

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMEVE NR. 243 ID DHE NR. 250, TË MONITORUESIT DHE NR. 258 ID, NR. 259 ID, NR. 260 ID, NR. 264 ID, NR. 265 ID, NR. 266 ID, NR. 267 ID, NR. 269 ID, NR. 270 ID, TË KOALICIONIT PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA NDAJ PERSONAVE PËRGJEGJËS, PËR RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 25 Prill 2023, sot unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjet administrative me:

**KËRKUES:** Monitorues  
Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)

**SUBJEKT:** Zj. Ornela Bena, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Prefekturën e Qarkut Korçë;  
Z. Mustafa Çarçiu, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Belsh;  
Z. Erjon Lalaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Kavajë;  
Z. Nertil Nebiaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Gjirokastrë.

**OBJEKT:** Shqyrtim administrativ ndaj personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike

**BAZA LIGJORE:** Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92, 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

### KONSTATOJ:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka marrë indicie për organizimin e 11 (njëmbëdhjetë) veprimtarive publike, nga 4 (katër) institucione publike, për të cilat pretendohet se nuk janë raportuar në ndërfaqen e dedikuar për këtë qëllim.

Denoncimet janë marrë nëpërmjet provave link, të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për t’u nisur hetimi administrativ.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundravajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Meqenëse në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë paraqitur disa denoncime nëpërmjet provave link të ndryshme dhe meqenëse objekti i shqyrtimit bazohet në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore, në mbështetje të nenit 65, shkronja “ç” të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, u vendos shqyrtimi së bashku i këtyre indicieve.

Në vijim të procedurës administrative, i është kërkuar informacion personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në institucionet shtetërore, në lidhje me veprimtaritë publike të raportuar në ndërfaqe.

Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka kërkuar nga institucionet publike nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljeve të pretenduara.

Subjektet objekt i këtij vendimi kanë paraqitur pretendime si më poshtë vijon:

1- **Prefekti i Qarkut Korçë** ka organizuar 2 (dy) veprimtari publike, **të regjistruara me nr. 243 ID dhe nr. 250 ID**, për të cilat pretendohet si më poshtë vijon:

- Denoncimi **nr. 243 ID**, “ *Vizitë në bashkinë Pogradec në promovim të investimeve. Aktivitet i paraportuar*”.

Prova link:

[https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid0VbGLLhdfqQwUXp19CUBp3j9JZ7zqCqxbiPWJn3c8iQjJ1h4rZrwYnRp4fDsHP7l&id=100064799406387](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid0VbGLLhdfqQwUXp19CUBp3j9JZ7zqCqxbiPWJn3c8iQjJ1h4rZrwYnRp4fDsHP7l&id=100064799406387)

Më datë 3.4.2023, personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike i është kërkuar informacion nëpërmjet adresës së postës elektronike në lidhje me denoncimin me nr. 243 ID. Personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në institucionin e Prefektit të Qarkut Korçë, nuk i është përgjigjur kërkesës tonë për informacion, në këto kushte, është vijuar me gjykimin e rastit në bazë të provave të administruara nëpërmjet rrjetit social “Facebook”, postuar në faqen zyrtare të Prefekturës së Qarkut Korçë.

Përsa më sipër, nga verifikimi i të dhënave dhe provave të administruara provohet se është një takim midis kryetarit të bashkisë Pogradec, dy nënkryetarëve të bashkisë Pogradec, Drejtorit të Kabinetit dhe Kryetarit të Këshillit Bashkiak.

Është arritur të identifikohen të pranishmit në këtë takim dhe konstatohet që janë personat sikurse referohet dhe në shkrimin bashkëlidhur këtij postimi.

Duke qënë se personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, nuk i është përgjigjur kërkesës sonë për informacion, në lidhje me vendin e zhvillimit të këtij takimi, konstatojmë se ky takim mund të jetë kryer në ambientet e institucionit të Preketit të Qarku Korçë, në shërbim të agjendës institucionale.

Veprimtaria nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së për veprimtaritë publike, ndonëse personat përgjegjës për raportimin kanë qënë përpara detyrimit formal për raportim. Mbështetur në arsyetimin e vendimit nr. 54, datë 11.04.2023, të KAS, “Takimet e punës që zhvillohen në mjediset e institucionit, në zbatim të agjendës dhe kompetencave institucionale, me persona ose grupe personash, duhet të ndahen nga kategoria e veprimtarive publike dhe të çlirohen nga detyrimi për raportim,sa kohë që ato nuk kanë lidhje dhe nuk i shërbejnë interesave elektorale të ndonjë subjekti politik”.

Në këto kushte, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti për këtë rast denoncimi nuk përmban elementë për konstatimin e shkeljes së dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

- "Denoncimi nr. 250 ID, " Prefekti i qarkut Korçe ka organizuar takim me studentë të Universitetit "Fan S. Noli, i cili rezulton të jetë i paraportuar".

Prova link:

[https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid037BZ8x1eoxqQPw5E1Ew47hAv6bN4SazfE18dJuRKLw3FeFysKbpuUqVLLDY6Pww8l&id=100064799406387](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid037BZ8x1eoxqQPw5E1Ew47hAv6bN4SazfE18dJuRKLw3FeFysKbpuUqVLLDY6Pww8l&id=100064799406387)"

*Theksohet se ky aktivitet nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator.*

Më datë 6.4.2023, personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike i është kërkuar informacion nëpërmjet adresës së postës elektronike në lidhje me denoncimin me nr. 250 ID. Personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në institucionin e Prefektit të Qarkut Korçë, nuk i është përgjigjur kërkesës tonë për informacion, në këto kushte, është vijuar me gjykimin e rastit në bazë të provave të administruara nëpërmjet rrjetit social "Facebook", postuar në faqen zyrtare të Prefekturës së Qarkut Korçë.

Përsa më sipër, nga verifikimi i të dhënave dhe provave të administruara provohet se është një takim i zhvilluar me studentë të rinj të universitetit "Fan Noli", në ambjettet e një lokali si dhe është arritur të identifikohet Prefekti i Qarkut Korçë, në këtë takim.

Në përfundim të hetimit administrativ, u provua se aktiviteti i mësipërm, referuar pikës 1, të nenit 92, të Kodit Zgjedhor ku përcaktohet se "Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre", veprimtaria e kryer në denoncimin e regjistruar me nr. 250 ID, përbën veprimtari publike dhe mbart detyrimin për raportim në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Referuar pikës 1, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor "Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik, që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve", Prefekti i Qarkut Korçe ka pasur detyrimin për raportim në ndërfaqen e raportimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Referuar pikës 3, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor "raportimi është përgjegjësi personale e personit përgjegjës për drejtimin administrativ të institucioneve publike, agjencive dhe ndërmarrjeve shtetërore (sekretarit të përgjithshëm të institucionit ose, sipas rastit, e drejtorit të përgjithshëm apo drejtorit ekzekutiv)".

Për sa më sipër, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar nenit 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, ku

parashikohet se “shkelja e dispozitave të Kodit Zgjedhor...nga persona të ngarkuar me detyra, sipas këtij Kodi, kur nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 3 000 deri në 90 000 lekë”, pasi ka vlerësuar në mënyrë të hollësishme veçmas çdo provë dhe të gjitha provat së bashku, të paraqitura nga administrata gjatë hetimit administrativ, konstaton se personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Prefekturën e Qarkut Korçë, ka shkelur pikën 1, të nenit 91 të Kodit Zgjedhor.

2- **Bashkia Belsh** ka organizuar 3 (tre) veprimtari publike, **të regjistruara me nr. 258 ID, nr. 259 ID dhe nr. 260 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:


- **Denoncimi nr. 258 ID**, “Në Seferanin e liqeneve një nga 100 fshatrat turistike të Shqipërisë, ku është bërë shumë, por ka ende shumë punë për të bërë.

#Tebashkuarjotendare 

#Pershqiperineqeduam  "

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=677286047738108&set=pcb.677286091071437>

- "Ndalesa e radhës  Dragot fermë, ku morëm mbështetjen e banorëve për vazhdimësinë e projekteve për mandatin e ardhshëm në dobi të banorëve”.

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=677758207690892&set=pcb.677758261024220>

- "Në Fierzë ku në vitin 2015 kemi furnizuar popullatën me bote uji të pijshëm, sot situata e furnizimit me ujë të pijshëm ka ndryshuar dukshëm dhe u bë i mundur regjistrimi fillestar i pronave pas 31 vjetësh.

#Tebashkuarjotendare 

#Pershqiperineqeduam  "

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=678656464267733&set=pcb.678656507601062>

*Theksohet se këto aktivitete nuk janë raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator.”*

Më datë 11.4.2023, personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Belsh, i është kërkuar informacion nëpërmjet adresës së postës elektronike në lidhje me denoncimet regjistruara me nr. 258 ID, nr. 259 ID dhe nr. 260 ID.

Personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në institucionin e Bashkisë Belsh, nuk i është përgjigjur kërkesës tonë për informacion, në këto kushte, është vijuar me gjykimin e rastit në bazë të provave të administruara nëpërmjet rrjetit social “Facebook”, postuar në faqen e kryetarit të Bashkisë Belsh.

Përsa më sipër, pas verifikimit të të dhënave, provave dhe faktet, të administruara gjatë hetimit administrativ, provohet se veprimtaritë publike rast hetimi janë zhvilluar në ambientet e lokaleve të ndryshme. Në aktivitetin e tretë regjistruar me nr. 260 ID, konstatohet se ka të pranishëm dhe fëmijë në këtë takim.

U provua se këto veprimtari publike, nuk janë postuar në faqen zyrtare të rrjetit social “Facebook”, të Bashkisë Belsh, megjithatë vlerësoj se janë veprimtari publike në kuptim të dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të cilat mbartin detyrimin për raportim në ndërfaqe.

Duke qënë se provat e administruara janë vetëm foto, nuk provohet nëse ka thirrje elektorale gjatë këtij takimi, por provohet se kryetari i bashkisë Belsh z. Tafani, ka qënë i pranishëm dhe ka mbajtur fjalën gjatë këtyre takimeve.

Konstatohet që takimet nuk kanë qënë rastësore për shkak së vërehet një numër i konsiderueshëm banorësh në këtë takim.

Nuk u arrit të provohet që në këtë takim ka pasur të pranishëm punonjës të bashkisë.

Në përfundim të hetimit administrativ, u provua se aktivitetet e mësipërme, kanë të njëjtën tematikë, “Takim me banorët”, në këto kushte referuar pikës 1, të nenit 92, të Kodit Zgjedhor ku përcaktohet se “Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre”, veprimtaritë e kryera në denoncimet e regjistruara me nr. 258 ID, nr. 259 ID, dhe nr. 260 ID, përbëjnë veprimtari publike dhe mbartin detyrimin për raportim në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Referuar pikës 1, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor “Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik, që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve”, bashkia Belsh ka pasur detyrimin për raportim në ndërfaqen e raportimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Referuar pikës 3, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor “raportimi është përgjegjësi personale e personit përgjegjës për drejtimin administrativ të institucioneve publike, agjencie dhe

ndërmarrjeve shtetërore (sekretarit të përgjithshëm të institucionit ose, sipas rastit, e drejtorit të përgjithshëm apo drejtorit ekzekutiv)".

Për sa më sipër, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar nenit 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, ku parashikohet se "shkelja e dispozitave të Kodit Zgjedhor...nga persona të ngarkuar me detyra, sipas këtij Kodi, kur nuk përbën veprë penale, dënohet me gjobë nga 3 000 deri në 90 000 lekë", pasi ka vlerësuar në mënyrë të hollësishme veçmas çdo provë dhe të gjitha provat së bashku, të paraqitura nga administrata gjatë hetimit administrativ, konstaton se personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Belsh ka shkelur pikën 1, të nenit 91 të Kodit Zgjedhor.

**3- Bashkia Kavajë ka organizuar 2 (dy) veprimtari publike, të regjistruara me nr. 269 ID dhe nr. 270 ID, për të cilën pretendohet si vijon:**

- Denoncimi **nr. 269 ID**, "Ndalesa në shkollën ""Mehmet Babamusta"", një godinë tashmë jo vetëm e rikonstruktuar por revolucionarizuar, na dhuroi emocione të forta. Sidomos për z. Lulzim, i cili me sy të përplotur riktheu për ne të gjithë, kujtimet e vjera të fëmijërisë së Indrit Carës, birit të shtrenjtë jo vetëm të familjes së tij, por Kavajës dhe Kosovës gjithashtu."

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=618394453439306&set=pcb.618394976772587>

- Denoncimi **nr. 270 ID**, "31-Mars, një ditë me emocione të mëdha për Kavajën! ❤️"

Sot patëm nderin që në homazhet e përvitshme për dëshmorin tonë Indrit Cara, të na bashkoheshin miq të vyer nga Komuna e Suharekës!

Na bashkon emri dhe vepra e një njeriu të rrallë: Një djali të ri me ideale të larta, që luftës së popullit shqiptar të Kosovës për të drejtën legjitime të lirisë dhe Pavarësisë i fali më të shtrenjtën gjë që kishte; Rininë dhe Jetën e tij! "

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=616461233632628&set=pcb.616463260299092>

Theksohet se këto veprimtari nuk janë raportuar në ndërfaqen e KQZ-së.

Më datë 12.4.2023, personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në bashkinë Kavajë, i është kërkuar informacion nëpërmjet adresës së postës elektronike në lidhje me denoncimet e regjistruara me nr. 269 ID dhe 270 ID.

Personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në institucionin e Bashkisë Kavajë, ndër të tjera bën me dije se “Unë në Erjon Lalaj me detyrë Sekretar i Përgjithshëm pranë Bashkisë Kavajë si dhe njëkohësisht personi përgjegjës pranë institucionit tuaj për raportim, nuk jam informuar për këto 2 aktivitete. Ndërkohë vendos në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve korrespondencën me organizuesit e këtyre aktiviteteve”.

Z. Lalaj vendos në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve shkresën nr. 1460 prot., datë 11.04.2023, nëpërmjet së cilës i drejtohet Drejtorisë së Kulturës, Turizmit, Trashëgimisë dhe Sporteve, mbi arsyen e mosraportimit të këtyre dy aktiviteteve. Gjithashtu shkresën nr. 146/1 prot, datë 12.04.2023, nëpërmjet së cilës bëhet ndër të tjera thuhet se “Aktiviteti organizohej në bashkëpunim me delegacionin i cili pritej të vinte nga Komuna e Suharekës...”.

Përsa më sipër, pas verifikimit të të dhënave, provave dhe faktet, të administruara gjatë hetimit administrativ, provohet se nuk janë postuar në faqen zyrtare të rrjetit social “Facebook”, të kryetarit të bashkisë Kavajë. Megjithatë vlerësoj se janë veprimtari publike në kuptim të dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të cilat mbartin detyrimin për raportim në ndërfaqe.

Duke qënë se provat e administruara janë vetëm foto, nuk provohet nëse ka thirrje elektorale gjatë këtij takimi, por provohet se kryetari i bashkisë Kavajë, ka qënë i pranishëm në të dyja këto takime.

Konstatohet që takimet nuk kanë qënë rastësore për shkak së vërehet një numër i konsiderueshëm njerëzish në këto takime.

U arrit të provohet se Drejtoria e Kulturës, Trashëgimisë, Kulturore, Turizmit dhe Sporteve, është drejtori brenda Bashkisë Kavajë.

Në lidhje me aktivitetin regjistruar me nr. 270 ID, vlerësoj se aktiviteti publik është organizuar edhe nga delegacioni i Komunës së Suharekës.

Në lidhje me aktivitetin regjistruar me nr. 269 ID, konstatoj se pavarësisht faktit dhe kërkesës për informacion drejtuar drejtorit të drejtorisë së Kulturës, Trashëgimisë, Kulturore, Turizmit dhe Sporteve, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarisë publike duhet ta kishte raportuar në ndërfaqen e KQZ-së, pasi është veprimtari publike e organizuar nga bashkia Kavajë dhe mbart detyrimin për raportim në ndërfaqen e dedikuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Në përfundim të hetimit administrativ, u provua se aktivitetet e mësipërme, kanë të njëjtën tematikë, “Takim me banorët”, në këto kushte referuar pikës 1, të nenit 92, të Kodit Zgjedhor ku përcaktohet se “Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për



pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre”, veprimtaria e kryer në denoncimin e regjistruara me nr. 269 ID, përbën veprimtari publike dhe mbarti detyrimin për raportim në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ndërsa vlerësoj pushimin e procedimit administrative, për denoncimin regjistruar me nr. 270 ID, duke i tërhequr vëmendje personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, të tregojë kujdes të shtuar në lidhje me raportimet institucionale të veprimtarive publike.

Referuar pikës 1, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor “Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik, që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve”, bashkia Kavajë ka pasur detyrimin për raportim në ndërfaqen e raportimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Referuar pikës 3, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor “Raportimi është përgjegjësi personale e personit përgjegjës për drejtimin administrativ të institucioneve publike, agjencive dhe ndërmarrjeve shtetërore (sekretarit të përgjithshëm të institucionit ose, sipas rastit, e drejtorit të përgjithshëm apo drejtorit ekzekutiv)”.

Për sa më sipër, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar nenit 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ku parashikohet se “shkelja e dispozitave të Kodit Zgjedhor...nga persona të ngarkuar me detyra, sipas këtij Kodi, kur nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 3 000 deri në 90 000 lekë”, pasi ka vlerësuar në mënyrë të hollësishme veçmas çdo provë dhe të gjitha provat së bashku, të paraqitura nga administrata gjatë hetimit administrativ, konstaton se personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Kavajë ka shkelur pikën 1, të nenit 91 të Kodit Zgjedhor.

**4- Bashkia Gjirokastrë, ka organizuar 4 (katër) veprimtari publike, të regjistruara me nr. 264 ID, nr. 265 ID, nr. 266 ID dhe nr. 267 ID për të cilat pretendohet si vijon:**

- **Denoncimi nr. 264 ID,** “Lunxhëri- Me disa banorë të Nokovës në një bashkëbisedim shumë të vlefshëm për të përmirësuar shërbimet tona e për të bërë ndërhyrjet aty ku është e nevojshme. Ndonëse nuk ka shqetësime për rrugën dhe as për furnizimin me ujë, gjithmonë dalin probleme për të cilat ne kemi përgjegjësinë t’u gjendemi pranë njerëzve. 🤝

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=937144247663850&set=pcb.937145120997096>

- **Denoncimi nr. 265 ID**, *Lunxhëri- Me disa banorë të Nokovës në një bashkëbisedim shumë të vlefshëm për të përmirësuar shërbimet tona e për të bërë ndërhyrjet aty ku është e nevojshme. Ndonëse nuk ka shqetësime për rrugën dhe as për furnizimin me ujë, gjithmonë dalin probleme për të cilat ne kemi përgjegjësinë t'u gjendemi pranë njerëzve.* 🤝

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=937144247663850&set=pcb.937145120997096>

- **Denoncimi nr. 266 ID**, *"Odrie- Bashkë me Mirelën patëm një diskutim shumë frymëzues me banorë të Labovës së Zhapës, fshatit me kaq shumë histori, njerëz punëtorë e potenciale të jashtëzakonshme për zhvillimin e agroturizmit e blegtorisë. Folëm pak e dëgjuam shumë nga njerëzit, me përlujtje e besim se kjo është rruga e duhur për t'u përmirësuar vazhdimisht dhe për t'u dhënë zgjidhje problemeve të mbetura".*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=935751604469781&set=pcb.935752144469727>

- **Denoncimi nr. 266 ID**, *"Lunxhëri- Me Mirelën në një bashkëbisedim të shkëlqyer me banorë të Erindit, për të folur për çfarë kemi bërë e për të dëgjuar shumë prej tyre për çfarë duhet të përmirësojmë e bëjmë akoma më tej. Basti ynë është me punën dhe përkushtimin ndaj njerëzve".*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=935646974480244&set=pcb.935647771146831>

Theksohet se këto aktiviteti nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator.”

Më datë 11.4.2023, personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Gjirokastrë i është kërkuar informacion nëpërmjet adresës së postës elektronike në lidhje me denoncimet regjistruara me nr. 264 ID, nr. 264 ID, nr. 266 ID dhe nr. 267 ID.

Personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në institucionin e Bashkisë Gjirokastrë, nuk i është përgjigjur kërkesës tonë për informacion, në këto kushte, është vijuar me gjykimin e rastit në bazë të provave të administruara nëpërmjet rrjetit social “Facebook”, postuar në faqen e kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë

Përsa më sipër, pas verifikimit të të dhënave, provave dhe faktet, të administruara gjatë hetimit administrativ, provohet se veprimtaritë publike rast hetimi janë zhvilluar në ambientet

e jashtme. Nuk provohet dhe nuk kosntatohet përdorimi i burimeve publike në këto veprimtari object denoncimi.

Në aktivitetet provohet dhe identifikohet prezenca e kryetarit të bashkisë dhe prezenca e zj. Mirela Kumbaro, por nuk provohet të ketë thirrje elektorale, për shkak se prova të administruara janë vetëm foto të postuar anë rrjetin social të z. Golemi.

U vërtetua që këto veprimtari nuk janë postuar në faqen zyrtarë të bashkisë Gjirokastrë.

Nuk u arrit të provohet që në këtë takim ka pasur të pranishëm punonjës të bashkisë.

Vërtetohet prania e një numri të konsiderueshëm banorësh në këto takime, ç'ka nënkupton që nuk kanë qënë veprimtari publike të rastësishme por të organizuara për tu zhvilluar. Mund të kenë qënë takime në kuadër të detyrave funksionale të kryetarit të bashkisë, por Kodi Zgjedhor dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, kanë specifikuar qartazi se detyrimet për raportim janë dhe për këto lloj veprimtarish publike.

Në këto kushte në përfundim të hetimit administrativ, u provua se aktivitetet e mësipërme, kanë të njëjtën tematikë, "Takim me banorët", në këto kushte referuar pikës 1, të nenit 92, të Kodit Zgjedhor ku përcaktohet se "Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre", veprimtari të kryera në denoncimet e regjistruara me nr. 264 ID, nr. 265 ID, nr. 266 ID dhe nr. 267 ID, përbëjnë veprimtari publike dhe mbartin detyrimin për raportim në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Referuar pikës 1, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor "Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik, që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve", bashkia Gjirokastrë ka pasur detyrimin për raportim në ndërfaqen e raportimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Referuar pikës 3, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor "raportimi është përgjegjësi personale e personit përgjegjës për drejtimin administrativ të institucioneve publike, agjencie dhe ndërmarrjeve shtetërore (sekretarit të përgjithshëm të institucionit ose, sipas rastit, e drejtorit të përgjithshëm apo drejtorit ekzekutiv)".

Për sa më sipër, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar nenit 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, ku parashikohet se "shkelja e dispozitave të Kodit Zgjedhor nga persona të ngarkuar me detyra, sipas këtij Kodi, kur nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 3 000 deri në 90 000 lekë", pasi ka vlerësuar në mënyrë të hollësishme veçmas çdo provë dhe të gjitha provat së

bashku, të paraqitura nga administrata gjatë hetimit administrativ, konstaton se personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Gjirokastrë ka shkelur pikën 1, të nenit 91 të Kodit Zgjedhor.

#### **V E N D O S:**

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike për denoncimet e regjistruara me nr. 250 ID dhe 270 ID:
  - a) Zj. Ornela Bena, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Prefekturën e Qarku Korçë;
  - b) Z. Erion Lalaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Kavajë;
2. T'i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative për denoncimet e regjistruara nr. 243 ID, 258 ID, 259 ID, 260 ID, 264 ID, 265 ID, 266 ID, 267 ID, 269 ID:
  - zj. Ornela Bena, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Prefekturën e Qarkut Korçë, gjobë në masën 5 000 (pesë mijë) lekë;
  - z. Mustafa Çarçiu, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Belsh, gjobë në masën 5 000 (pesë mijë) lekë;
  - z. Nertil Nebiaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Gjirokastrë, gjobë në masën 5 000 (pesë mijë) lekë;
  - z. Erion Lalaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Kavajë, gjobë në masën 5 000 (pesë mijë) lekë.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**